



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.88/24

Datë: 27.09.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 27 .09.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve ndërmarrjeve lidhur me blerjen e propozuar të aksioneve nga Helenos (blerës), Credit Cooperatif (shitës) mbi Kreditimi Rural i Kosovës L.L.C., (targeti).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 07.08.2024, me Nr. Prot. 501/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e propozuar të aksioneve nga Helenos (blerës), Credit Cooperatif (shitës) mbi Kreditimi Rural i Kosovës L.L.C.,

Procedurat e ndjekura:

- Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 29.08.2024
- Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 30.08.2024
- Transaksioni bazohet Marrëveshjen e Shitblerjen e Aksioneve të lidhur me 21 Korrik 2024 e cila është miratuar paraprakisht si Transaksion nga Aksionarët e tjerë të Kompanisë së synuar.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni

18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në transaksion:

Helenos, është kompani e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Mbretërisë së Belgjikës, me numër të biznesit 0700.505.789 me seli në Avenue Jules Cesar 2/7, 1150 Woluwe-Saint-Pierre, Belgjikë. Helenos është fondi i parë investues privat në Evropë i dedikuar financave gjithëpërfshirëse, i krijuar për të forcuar bazën e kapitalit të ndërmjetësve financiar që synojnë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe sociale. Helenos ofron fonde investuese, hua të rangut të ulët dhe të larta. Fondi përfiton nga mbështetje e Programit të Komisionit Evropian për Punësimin dhe Inovacion Social (*European Commission's Programme for Employment and Social Innovation*).

Kreditimi Rural i Kosovës L.L.C., kompani e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me numër unik identifikimi 810483496 me seli në Rruga Behije Dashi, Nr. 20, 10000 Prishtinë, Kosovë. Kreditimi Rural i Kosovës është institucion mikrofinanciar i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), i cili ofron shërbime financiare për bizneset me të ardhura të ulëta, me fokus të veçantë në bizneset mikro, biznese të vogla dhe aktivitete të tjera në zonat rurale dhe zonat urbane, me fokus primar në bujqësi dhe fokus të veçantë social në qëndrueshmërinë ekonomike dhe çështjet mjedisore.

Credit Cooperatif, kompani e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Francës me numër biznesi 349 974 931 me seli në 12 BD de Pesaro, 92000 Nanterre, Republika e Francës nga Parashtruesi i Kërkesës. Credit Cooperatif është një korporatë franceze e cila synon të nxisë zhvillimin e ndërmarrjeve të ekonomisë sociale, shoqatave, korporatave, shoqërive të përbashkëta, grupeve të kompanive, ndërmarrësve social dhe subjekteve me interes të përgjithshëm.

Tregu i produktit: Tregu për dhënie e kredive nga institucionet mikrofinanciare ose tregu i lëshimit të mikrokredive.

Tregu gjeografik: do të konsiderohet, *Republikës së Kosovës*.

Analiza e konkurrencës - Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Bazuar në vlerësimin e tregut përkatës të produktit, përkatësisht tregu i lëshimit të mikro-kredive në Kosovë, janë nëntë (9) institucione mikrofinanciare (jobankare) të licencuara. Struktura e tregut si lëshues të kredive mbulon 19.1% të përqindjeve, në tregun e produktit përkatës, ndërsa Kreditimi Rural i Kosovës, mban rreth 22.07%, (ref. nga raporti i BQK-së), të pjesës së tregut në tregun, e cila konsiderohet të mos ketë pozitë dominuese në tregun përkatës. Transaksioni i propozuar, nuk do të ndikojë në tregun e Republikës së Kosovës dhe si i tillë nuk ngrit shqetësim për konkurrencën dhe as konsumatorët në Republikën e Kosovës. Bazuar në sa më sipër, rezulton se Transaksioni i Propozuar, nuk do të ndikojë në konkurrencën, në Kosovë.

¹https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2024/08/Lista-e-institucioneve-financiare_12.02.2024-005.pdf

https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2024/10/BQK_SF_Gusht-2024.pdf

Duke pasur parasysh se Aplikuesi (blerësi) nuk është prezentë në tregun e Republikës së Kosovë përmes ndonjë filiali, por vetëm për mes dy kredive që ka dhënë për mikrofinancat tjera në Kosovë, si dhe duke pasur parasysh që tregu financiarë është tregu i rregulluar dhe i mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Kosovës, ekzistojnë tri lloje të institucioneve të cilat janë të licencuara për të lëshuar kredi, përkatësisht Bankat. Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo-bankare. Prandaj, Kompania e synuar është e licencuar si institucion mikrofinanciar, duke ofruar shërbimet e dhënies së mikrokredive dhe nuk ofron shërbime tjera. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, sa i përket mbivendosjeve të mundshme horizontale, në tregun përkatës të Republikës së Kosovës përqendrimin i propozuar nuk implikon mbivendosje të konsiderueshme, horizontale. Bazuar në sa më sipër, rezulton se transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë dhe se është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga "Njoftimi" nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva